



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 69

14:00

U R D H Ë R

PËR

PARAQITJEN NË DETYRË PRANË QENDRËS SË VOTIMIT, TË OPERATORËVE TË PAJISJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE (PEI), PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të neneve 14 dhe 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.11, datë 25.3.2021, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, të ndryshuar

U R D H Ë R O J M Ë:

1. Operatori i pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), duhet të paraqitet në qendrën e votimit ku është caktuar nga KQZ-ja, në orën 06:00 të datës 14 maj 2023.
2. Mosparaqitja e operatorit në qendrën e votimit në orën e përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, e ngarkon atë me përgjegjësi ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Ilirjan CELIBASHI

Data: 13.5.2023 Nr. 69
Ora:14:00



“Për paraqitjen në detyrë pranë qendrës së votimit, të operatorëve të pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”